



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **16.11.2023**, me fillim në orën **10:45**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it dhe gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e 11-të të **Komitetit për Politikë dhe Financa** për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës, kemi përgatitur këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim paraprak të pronës së paluajtshme komunale, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër 1-15 vjet;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01728-1, ZK-Rahovec;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-02240-1, ZK-Rahovec;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01422-1, ZK-Rahovec;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510033-00550-2, ZK-Xërxë;
7. Të ndryshme.

## PIKAT SHITESË

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00386-1, në Zonën Kadastrale në Pastaselë.

**Afrim Oruçi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, për pikën shtesë që e propozoi kryesuesi me hedh në rend të ditës me urgjencë, për shkak se është një projekt për ndërtimin e shkollës fillore të mesme të ulët në zonën kadastrale në Pastaselë. Parcela ku është e ndërtuar shkolla aktualisht, do të jetë edhe shkolla ku do të ndërtohet, e cila është në menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës, kështu që me urgjencë është dashur t'hiqet, me shpall me interes të përgjithshëm e më pas me këmbë, për të marrë projektin lejen të bëhet pronë e Komunës. Kjo është arsyeshmëria për shkak të rekomandimeve prej Ministrisë së Arsimit.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, i hedhim në votim pikat shtesë të propozuara. Me shumicë të votave dhe një votë abstenim, kalojnë për kuvend pikat shtesë të rendit të ditës. Tani e hedhim në votim rendin e ditës. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së, aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë:

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Meqë nuk kemi asnjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Me shumicë të votave, aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

### **2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim paraprak të pronës së paluajtshme komunale, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër 1-15 vjet.**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar anëtarë të KPF-së, sipas ligjeve në fuqi, kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa me marr vendim për ta dhënë pronën me qira, që është pronë e komunës, personave fizikë dhe juridikë prej 1-15 vjet, ku të dyja pronat gjenden në zonën kadastrale në Xërxë. Qëllimi i këtij vendimi është që pastaj nëpërmjet ankandeve publike t'u japim me qira këto parcela njerëzve që janë të interesuar. Ju ftoj që pas shqyrtimit të votoni propozim-vendimin e kryetarit të Komunës për dhënien e pronave komunale me qira.

**Burim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kërkoj mirëkuptimin nga ju drejtor, që kur t'i kemi për seancën e rregullt këto parcela, që të ketë ortofoto prej gjeoportalit, që të ketë mundësi me pa se ku bëhet fjalë saktësisht, meqenëse kemi me votu si proces.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtareve të Komitetit për Politikë dhe Financa, kalon për kuvend. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01728-1, ZK-Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar anëtar të KPF-së. Bëhet fjalë për një parcelë private që është në zonën kadastrale në Rahovec, prona është në emër të Agim Xhafer Kastratit, me sipërfaqe prej 4 ari e 30 m<sup>2</sup> dhe në bashkëbisedim me pronarin, ne po provojmë me shpall me interes të përgjithshëm vetëm 12 m<sup>2</sup> prej sipërfaqes së përgjithshme prej 4 ari e 12 m<sup>2</sup>, me qëllimin e vetëm se parcela gjendet në rrugën "Vëllezërit Frashëri" në Rahovec, që të këmbëjë dhe t'i ofrojë zgjidhje lagjes dhe KED-sit, për ta vendosur një trafo për këtë lagje. Ju ftoj që pas shqyrtimit, të votoni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës së përmendur në fjalë.

**Defrim Kafexhiu** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Vetëm deshta me falënderu ekzekutivin dhe me përgëzu për iniciativën dhe gjithashtu i ftoj kolegët anëtarë të KPF-së që me votu këtë pikë të rendit të ditës për shkak se është nevojë jetike për banorët e asaj lagjeje.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtareve të KPF-së, kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

### **4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P- 71510057-02240-1, ZK-Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Kryetari i Komunës, sipas ligjeve në fuqi, u propozon anëtarëve të KPF-së që parcelën me numër 02240-1, me sipërfaqe mbi 700 hektarë, e cila është në menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës, pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 3 hektarë dhe kjo parcelë saktësisht gjendet në rrugën Rahovec-Malishevë, pikërisht në anën e djathtë të rrugës dhe në anën e majtë e ka hapësirën që po mundohemi me kthy në hapësirë të gjelbëruar. Pra, bëhet fjalë për një gjatësi mbi 350 metra përskaaj rrugës dhe me një gjerësi prej 100 metra dhe për shkak të interesimit të njerëzve afaristë, bizneseve të Komunës së Rahovecit. Po mundohemi me shpall me interes të përgjithshëm e pastaj me këmbë, me bë pronë të Komunës dhe bashkë me juve, me iu dhënë njerëzve në shfrytëzim. Ju ftoj që pas shqyrtimit, ta votoni propozim-vendimin me interes të përgjithshëm të kësaj pjese që menaxhohet prej Agjencionit Pyjor të Kosovës.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, kalon për Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës;

**5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01422-1, ZK-Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të një pjese të parcelës, prej sipërfaqes së përgjithshme prej 6 ari 79 m<sup>2</sup>, kurse ne e shpallim për interes të përgjithshëm vetëm 1 ari 132 m<sup>2</sup>. Kjo parcelë gjendet diku në mes të parcelave që po ndërtohet sheshi qendror i qytetit dhe është në menaxhimin e ujërave, ku faktikisht dhe aktualisht në terrene nuk shihet kjo parcelë dhe krejt çka ne po bëjmë është me shpall me interes të përgjithshëm që me këmbi, me bë pronë të komunës dhe në një të ardhme jo të largët, me i bë krejt bashkë këto parcela pasi janë mbi dhjetë parcela dhe me identifiku si parcelë që është i ndërtuar sheshi qendror i qytetit. Ju ftoj me votu propozimin për interes të përgjithshëm për parcelën në fjalë në sipërfaqe prej 132 m<sup>2</sup> prej sipërfaqes se përgjithshme.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së, kalon për Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510033-00550-2, ZK-Xërxë**

**Afrim Oruqi** – Kjo parcelë gjendet në zonën kadastrale në Xërxë dhe është fjala për një sipërfaqe të parcelës private në emër të pronarëve të përmendur me propozim. Pra, në certifikatë i keni 100 m<sup>2</sup> dhe ne po bëjmë fjalë për 42 m<sup>2</sup> që kanë mbetur prej pjesës së përgjithshme, ku kemi hapur një rrugë atje pasi kemi këmbyer dhe i kemi marrë një parcelë prej pronës private, pasi ka pasur kërkesa të vazhdueshme prej komunitetit ,pra, prej banorëve, që me zgjeru këtë rrugë. Kështu që na kanë mbetur këto metra katror të uzurpuara prej një pronari tjetër dhe në momentin kur ta shpallim me interes të përgjithshëm, para se me këmbi kemi me kerku prej pronarëve me liru që me pas mundësi me zgjeru rrugën dhe pastaj zhvillojmë procedura të tjera. Për momentin, jemi në këtë fazë dhe ju ftoj që me shpall me interes të përgjithshëm këtë sipërfaqe prej 42 m<sup>2</sup> prej sipërfaqes së përgjithshme prej 100 m<sup>2</sup> në emër të pronarëve të përmendur në propozim.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së, kalon për kuvend edhe kjo pikë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera**

**Fatmir Iska** – I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Para vetes e keni raportin dhe unë shkurtimisht mund t’ju them dëmet e shkaktuara gjatë periudhës qershor dhe korrik, si në vreshta, specat, kungull, lakër, lulëlakër, pjepër, shalqi, qepë, patate, domate, hudhër. Kryetari ka nxjerrë një vendim për formimin e një komisioni për vlerësimin e dëmeve dhe janë parashtruar gjithsej 427 kërkesa dhe nga këto kërkesa, komisioni i ka konstatuar 235 që janë aprovuar me vlerë 661,987 euro, ku 12 kërkesa kanë qenë të përsëritura dy herë dhe një kërkesë është parashtruar gabim, kurse 179 kërkesa janë refuzuar, pasi nuk i kanë plotësuar kriteret. Vendbanimet ku janë shkaktuar këto dëme janë fshatrat: Nagac, Brestoc, Hoçë e Vogël, Xërxë, Bellacerk, Celinë, Krushë e Madhe, Pataqan i Ulët, Dobidol dhe Çifllak. Gjithashtu, në fshatin Brestoc janë shkaktuar dëme edhe në amvisëri, ku janë paraqitur 8 kërkesa, ku 7 prej tyre janë aprovuar në vlerë prej 18,595 euro, ndërsa për një kërkesë nuk ka pasur disponim të pronarit, në bashkëpunim me komisionin.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit nënkryetar, po besoj që ne seancën e rregullt këto 179 kërkesa të refuzuara për shkak të mosplotësimit të kriterëve, do të ishte mirë me na dhënë informata më të plota nga komisioni se pse janë refuzuar që munden me qenë edhe si pjesë përfshirëse e raportit edhe me pas si informatë që vlera e dëmit të shkaktuar prej 661,187 euro a është kompensuar apo pritet me u kompensu.

**Fatmir Iska** – Rreth kësaj duhet të diskutojmë edhe me drejtorin e Bujqësisë që te mos japim informata jo të sakta dhe do të shohim mundësinë e përfshirjes së arsytimit të komisionit për ato që ka hasur në vendngjarje edhe gjithashtu për vlerën. Kështu që, sipas informacioneve të sekretariatit, ky raport duhet të votohet në kuvend, që të merret vendimi për vazhdimin më tutje dhe në seancën e Kuvendit, do të jetë prezent edhe drejtori i Bujqësisë e po ashtu edhe kryetari dhe do të japin informata më të hollësishme.

**Burim Krasniqi** – Atëherë, meqë duhet me pas votim, do të jetë edhe më e arsyeshme që me u kompletu me informata shtesë ky raport.

**Kryesuesi** - Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera për këtë pikë, vazhdojmë me pikën e radhës:

## **8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024**

**Afrim Limani** – Sipas ligjit të tatimit në pronë, kuvendet komunale janë të obliguar që për çdo vit t'i votojnë normat tatimore, në bazë të vlerësimit të dalë nga ligji i tatimit në pronë. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në këtë vit i kemi dy ndryshime, kryesisht për njësinë rezidenciale të parcelave, të cilat kanë qenë 0.15 dhe ne kemi propozuar një zbritje prej 0.13% dhe për njësinë rezidenciale të objekteve, që ka qenë 0.15% dhe ne kemi propozuar të rritet në 0.19%. Këtë rritje dhe këtë zvogëlim e kemi propozuar për shkak se ligji i tatimit në pronë duke u bazuar në ligjin bazik dhe ndryshimet të cilat janë krijuar në ligjin 06L005 për tatimin në pronën e palejueshme dhe nëse i referohemi nenit 9 të shkallës tatimore dhe pikës 3, i cili thotë: për vlerën për pronat deri në 100 euro, aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë nga 0.10 deri në 1. Kështu që, deri më tash, para këtij plotësim-ndryshimi ka qenë 0.15 dhe tash kufiri më i ulët 0.10%. Kjo është arsyeja që kemi dalë me një rritje në propozim dhe neni 3, i cili thotë: për vendbanim parësor deri në 30,000 euro të pronës së vlerësuar për personin fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të këtij viti. Pra, shkalla e zbritjes që deri më tash ka qenë 15,000 euro dhe tash është rritur dhe u bë 30,000 euro. Pikërisht, bazuar në këto dy nene, pra nenin 9 dhe 3 dhe ne si Drejtori e Financave kemi punuar një periudhë të gjatë dhe kemi bërë analiza të shumta dhe kemi ardhur në përfundim se kemi bërë një propozim prej 0.19% rritje dhe te parcelat, zbritje për 0.13%. Pra, rritjen te objektet e kemi bërë me arsyen se zbritja e vendbanimit primar ka qenë 15,000 dhe tash është 30,000 dhe përfundimi është kështu duke u bazuar në këto ndryshime të ligjit të tatimit në pronë. Ne ju kemi dërguar juve të nderuar asambleistë edhe një dokument, ku i kemi bërë disa kalkulime dhe kemi marrë një mesatare, ku i kemi marrë dy shtëpi, të cilat kanë nga 200 m<sup>2</sup> dhe tjetra 150 m<sup>2</sup>. Duke e ditur se mesatarja e ngarkesës së tatimit në pronë, ku afërsisht shumë më e madhe shkon në kuadër të këtyre metrave katror. Nëse bëjmë një krahasim me normën e kaluar për pronën rezidenciale, kuptohet shtëpi, atëherë ne kemi zbritje në të gjitha zonat, me përjashtim te zona e parë që ka një ndryshim dhe gjithmonë në raport me vitin e kaluar dhe jo vitin 2023, që ka pasur rritje enorme tatimore të vlerësimit. Pra, me këtë propozim 0.19%, pos zonës së parë, ka zbritje në gjashtë zona për shtëpi. Kurse te parcelat nuk ka zbritje për banim primar, por ne kemi shkuar me një zbritje nga 0.15% sa ishte dhe e kemi propozuar në 0.13%. Po ashtu, në bazë të analizave që i kemi bërë edhe kemi dalë me disa rezultate, pra, pikërisht kjo rritje e shkallës për banim primar i eliminon të gjitha objektet që kanë vlerën deri në 100 m<sup>2</sup> dhe numri i tatimpaguesve që nuk paguajnë tatim është 7808, që në vitin 2023 ka qenë 2053 tatimpagues, që realisht kanë qenë pa ngarkesa tatimore. Ndërsa tani, në kuadër të këtij propozimi janë 7808 tatimpagues, pra vlera e ngarkesës në raport me vitet e kaluara në kuadër të këtij plotësim-ndryshimi, është afërsisht mbi 250,000 euro. Të nderuar anëtarë të KPF-së, ju ftoj që ta votoni këtë propozim.

**Burim Krasniqi** – Nga ajo që shihet në material, tabelat nuk janë në të njëjtën faqe dhe tabelat që i kemi në email është problem me i bë bashkë për me pas mundësi me i lexu dhe me bë krahasimin e tyre. Kështu që, nëse është mundësi me i pas me një tabelë për seancën e Kuvendit dhe gjithashtu e pata një pyetje te tatimi në parcela bujqësore, se a ka filluar me u zbatu, apo ende nuk ka filluar, pasi këtu figuron si vlerë, si përqindje, mirëpo ku qëndron zbatueshmëria e saj apo sa është presioni për me zbatu edhe si do të trajtohet pjesa e parcelave që punohet dhe nuk punohet, pasi shihet se për njësi bujqësore të parcelave është 0.16%, pra kjo a është e njëjtë edhe për parcelat që punohen edhe për ato që nuk punohen apo do të ketë presion që me u punu tokat bujqësore, meqenëse është vendim që duhet me votu Asambleja komunale. Po ashtu, vlera e pronave a është caktuar nga departamenti i tatimit në pronë, i Ministrisë së Financave apo nga Komuna e Rahovecit.

**Afrim Limani** – Për mbledhje të Kuvendit, Zyra e Sekretarisë do të kujdeset me i selektu dhe me i rregullu para se me iu dërgu në email. Siç e thashë më herët se kemi marrë dy mostra, pra një shtëpi me 200 m<sup>2</sup> dhe një shtëpi tjetër me 150 m<sup>2</sup>, pasi mesatarja sillet këtu edhe sigurisht se këto më së shumti taten, pasi numri më i madh i tatimpaguesve është te këto prona, P.sh.: një shtëpi me 200 m<sup>2</sup> dhe vlera

për m<sup>2</sup> është 200 euro dhe shuma del që është 40,000 euro dhe minusohet zbritje për banim primar dhe del vlera 25,000 dhe shumëzohet me koeficiente edhe del vlera reale dhe kjo ishte për vitin 2022. Tani e kemi vitin 2024, prona me 200 m<sup>2</sup> dhe vlera në vitin 2023 është rritur në 300 euro që del 60,000 dhe zbritje për banim primar 30,000 x 30,000x, koeficienti 0.19% dhe del vlera 57 euro dhe ndryshimi është 17 euro, d.m.th. është e vetnija zone që nuk zbritet, pasi gjithmonë në raport me vitin 2022 e kam marr shembullin. Kështu që për seancën e Kuvendit do të ju prezantoj edhe në monitor që me pas mundësi me pa dhe me verifiku. Pastaj rreth tokave bujqësore, mund të them se vetëm jemi duke pritur një njoftim zyrtar nga departamenti se nga viti i ardhshëm do të fillojë tatimi i pronave bujqësore. Ne e kemi vlerësimin e tokave bujqësore që, sipas ligjit të tatimit në pronë, bëhet një herë në katër vjet, kështu që në vitin 2024 pritet me ndryshu dhe me u bë rivlerësim, por janë normat e njëjta tatimore, sikur që është bërë vlerësimi para katër viteve. Mirëpo, tatimi në toka bujqësore nuk ka filluar së aplikuari ende dhe pritet me fillu nga viti 2024.

**Burim Krasniqi** – Te çështja e tatimit në pronë, problemi kyç është trashëgimia. Unë e di që mundet me u lidh një pjesë me kërkesën mbi subvencionim që me ditë se kush po e merr subvencionin e që pastaj me bart edhe barrën e saj. Por, ka shume parcela e sidomos në zonat pak më kodrinore të cilat nuk punohen edhe ekzistojnë në emër të stërgjyshit edhe nuk ka kërkesa për subvencionim dhe kjo mendoj se është sfida me e madhe. Kështu që a është menduar ndonjëherë apo është diskutuar ndonjëherë me ministrin e Financave rreth kësaj që po e merr shteti dhe si me zgjidh. Po ashtu, ka edhe prona të shitura, të patrashëguara dhe sigurisht se ne e kemi obligim me votu, por do të jetë sfidë e vazhdueshme për implementim.

**Afrim Limani** – Sipas të dhënave që i kemi, as 30% e qytetareve nuk i kanë pronat në emër të tyre. Pra, mbi 70% i kanë pronat në emër të paraardhësve dhe tatimi bëhet në atë mënyrë që ai që është më dokumente pronar. Departamenti i Tatimit në Pronë, të gjitha të dhënat për parcela i ka marrë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës dhe i ka futur në sistem, i ka përpunuar. Pra, parcelat, malet edhe livadhet, kanë filluar para 4 viteve me u tatu, ashtu si janë të regjistruara në kadastër dhe tash në vitin 2024 pritet me fillu edhe për toka bujqësore.

**Burim Krasniqi** – Një parcelë e tokës bujqësore që punohet, edhe një parcelë që lihet e pa punuar (batall), a do të ketë dallim tatimi në pronë, me qellim që me shty me punu secili, pra ai është pronar, mirëpo nuk do me punu, e paguan njëjtë sikur ai që i jep kontribut zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Rahovecit.

**Afrim Limani** – Tani për tani jo, mirëpo unë besoj që do të marrim ndonjë rregullore apo udhëzim gjithsesi. Pasi nuk bën me u tatu një tokë bujqësore pjellore, ndërsa tjetra që është djerrinë. Kështu që nuk kemi informata rreth kësaj, mirëpo ne jemi të regjistruar në sistem në ara. P.sh.: nëse ke 1 hektar, atëherë të bie me pagu afër 30 euro për token që e keni punuar. Kështu që, njëherë nuk kemi të dhëna për këtë, por besoj që do të dalë ndonjë rregullore që do e qartësonte këtë. Pra për shkak të zhvillimit të sistemit informativ munden me i nxerr keto të dhëna, i futin në sistem i përpunojnë, por me siguri nxjerrin ndonjë rregullore që nëse nuk punohet një arë, atëherë nuk tatimohet.

**Kryesuesi** - Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së, kalon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

#### **10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00386-1, në Zonën Kadastrale në Pastaselë**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar anëtarë të KPF-së. Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Pastaselë, konkretisht për zonën ku është aktualisht e ndërtuar shkolla fillore e mesme e ulët në Pastaselë, me numër të parcelës: P-00386-1. Ne po kerkojmë me shpall me interes të përgjithshëm vetëm sipërfaqen 1 hektar 7 ari 15 m<sup>2</sup>. Qëllimi i këtij interesi të përgjithshëm është që pastaj ta këmbejmë dhe ta bëjmë pronë të Komunës dhe ta procedojmë me kërkesa të tjera për leje të projektit për ndërtimin e shkollës. Ftoj anëtarët e KPF-së që, pas shqyrtimit, të votojnë propozimin për interes të përgjithshëm për pjesën e parcelës me numër të përmendur më lart. Kerkojmë ndjesë për mungesën e materialit, mirëpo për mbledhjen e kuvendit do të kujdesemi që ta kemi.

**Kryesuesi** – Ateher, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së dhe një kundër, kalon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

#### **11. Të ndryshme**

**Defrim Kafexhiu** – Faleminderit kryesues, unë vetëm desha me pyet dikë nga ekzekutivi kushdo që ka informata me u përgjigj për çështjen e PZhK-së, që a ka ardhur, apo ende duhet të presim dhe a ka mundësi me ardh për seancë të rregullt të Kuvendit.

**Kryesuesi** – Për këtë çështje, do të ju njoftojmë z. Kafexhiu, nga informacionet që do të vijnë nga ekzekutivi.

Kështu që, pasi nuk kemi diskutime të tjera, e konstatoj të mbyllur këtë seancë dhe shihemi mbledhjet e radhës.

**Mbledhja përfundoi: 11:30**

**Procesmbajtësi:**

  
**Agim Hoti**

  
**KRYESUESI**  
**Arbër Zenuni**